



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1604, datë 07.06.2011

Për

“Fillimin e procedimit administrative për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Eagle Mobile sh.a dhe Plus Communication sh.a”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 07.06.2011, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brëndshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Eagle Mobile sh.a dhe Plus Communication sh.a.

BAZA LIGJORE:

1. Neni 49, neni 50 pika 1, neni 60 dhe neni 120 e vijues, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**Ligji nr. 9918**);
2. Neni 46 e vijues të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore nr. 18 “Për procedurat e zgjidhjes se mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Rregullore nr. 19 “Për Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;

5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008,

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Shkresa e sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a me nr. 1784 prot, datë 04.05.2011 “Kërkesë për zgjidhje moasmarrëveshje midis Eagle Mobile sh.a dhe Plus Communication në lidhje me marrëveshjen e re të interkoneksionit midis palëve” (AKEP: 591/4 prot, datë 05.05.2011);
 - Emali i Eagle Mobile dërguar Plus më datë 17.02.2011;
 - Shkresa e Eagle Mobile nr. 1380, datë 05.04.2011;
 - Shkresa e Plus nr. 244, datë 08.04.2011;
 - Shkresa e Eagle Mobile nr. 1526, datë 18.04.2011;
 - Shkresa e Eagle Mobile nr. 1480 datë 13.04.2011;
 - Shkresa e Plus nr. 309 datë 26.04.2011;
 - Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (*Relacioni*);
 - si dhe,
- duke i’u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar.

V Ë R E N:

Eagle Mobile me shkresën nr. 591/4 prot, datë 05.05.2011 “Kërkesë për zgjidhje moasmarrëveshje midis Eagle Mobile sh.a dhe Plus Communication sh.a në lidhje me marrëveshjen e re të interkoneksionit midis palëve” sqaron se:

1. Eagle Mobile, në zbatim të Vendimi nr. 1505, datë 10.02.2011 të Këshillit Drejtues të AKEP “Miratimin e dokumentacionit final për orientimin në kosto të shërbimeve të operatorëve celular me FNT”, më datë 17.02.2011 ka dërguar në formë elektronike draft marrëveshjen me Plus;
2. Plus ka dërguar më datë 16.03.2011 draftin e plotësuar të marrëveshjes dhe ka vendosur tarifën e terminimit në rrjetin e Plus prej 18.9 lek/min dhe 0.57 lek/thirrje, gjithashtu Plus ka kërkuar edhe ndryshime në tekstin e marrëveshjes;
3. Eagle Mobile, në shkresën nr. 1380 prot, datë 05.04.2011 ka arsyetuar se marrëveshja midis palëve duhet të bazohet në RIO dhe Vendimet mbi tarifën e miratuara nga AKEP;
4. Plus pretendon në përgjigjen e dërguar me shkresën nr. 244, datë 08.04.2011 se referenca e Vendimit të AKEP nr. 1505 i referohet vetëm operatoreve celularë FNT, dhe është një Vendim orientues për Plus, duke theksuar se tarifën per Plus ngelen të njëjtat deri më 31.08.2011;
5. Eagle Mobile me shkresën nr. 1526 prot, datë 18.04.2011 i përgjigjet Plus duke e sqaruar se ruajtja e tarifës së terminimit prej 18.9 lek/min dhe 0.57 lek/thirrje nga ana e Plus është

- në kundërshtim me Vendimet nr. 1505, nr. 1351 të AKEP, kuadrit rregullator në fuqi si dhe rekomandimeve të KE për asimetrinë midis operatorëve;
6. Eagle Mobile thekson se, pretendimi i Plus do të sillte rritjen e asimetrisë së Plus me Eagle Mobile krahasuar me asimetrinë e tarifave para datës 1 Mars;
 7. Gjithashtu Eagle Mobile, argumenton se Vendimi nr. 1351, datë 04.08.2011, i KD të AKEP nuk përcakton se tarifat e Plus duhet të jenë të pandryshueshme deri më datë 31.08.2011;
 8. Eagle Mobile me shkresën nr. 1480 prot, datë 13.04.2011 ka kundërshtuar faturat e Plus për muajin Mars dhe ka informuar Plus për dërgimin e çështjes në AKEP, në rast mospranimi të tarifave të reja për Plus;
 9. Plus me shkresën nr. 309 prot, datë 26.04.2011, konfirmon përsëri faturat me tarifë termimi prej 18.9 lek/min dhe 0.57 lek/thirrje;
 10. Së fundmi Eagle Mobile në zbatim të nenit: 49, 50, 60, 120 të Ligj nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, neni 15 i Rregullores “Për Akses dhe Interkoneksion”, neni 5 dhe 7 të Rregullores “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”, kërkon:
 - Marrjen e Vendimit për shpalljen e Plus OFNT në tregun e terminimit me shumicë në rrjetin përkatës;
 - Nxjerrjen e Urdhërit të AKEP për lidhjen e marrëveshjes së re të interkoneksionit midis Eagle Mobile dhe Plus, me tarifë terminimi në rrjetin e Plus prej 15.93 lek/min prej datës 01.03.2011 deri më 31.08.2011, pa aplikuar tarifë për thirrje dhe sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në RIO e Eagle Mobile;
 11. Duke qënë se, sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a dhe Plus Communication sh.a megjithë negociatat, takimet dhe përpjekjet e bëra, nuk kanë arritur të bien dakord mbi tarifën e terminimit, AKEP në zbatim të nenit 50 dhe në vijim të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” zgjidhja e mosmarrëveshjes midis sipërmarrësve mund të kryhet në bazë të kërkesës së një sipërmarrësi apo me inisiativën e AKEP,

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 te nenit 115, te Ligjit nr. 9918, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 te nenit 21 te Rregullores së Brëndshme,

V E N D O S:

1. Të fillojë procedimim administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Eagle Mobile sh.a dhe Plus Communication sh.a.;
2. Të ngrihet komisioni për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me përbërje si:
 - Altin Rrapaj Kryetar
 - Jonida Gjika Anëtar
 - Nuredin Hasanaj Anëtar

- Florida Çela Anëtar
 - Esmeralda Dervishi Anëtar
3. Të njoftohen palët e interesuara Eagle Mobile sh.a dhe Plus Communication sh.a për fillimin e procedimit administrativ;
 4. Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e Vendimit;
 5. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al
- Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I
Piro XHIXHO

ANËTARË:

- 1. Alketa MUKAVELATI**
- 2. Benon PALOKA**
- 3. Ibsen ELEZI**
- 4. Zamira NURCE**